

**STATUT DHE AKT THEMELIMI  
PER KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK, SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“KAÇI LAW & IMMIGRATION”**

Sot me date 27.08.2024 (dy mije e njezete e kater) une i nenshkruari:

**Z. ARBËR KAÇI** i biri i Viktor dhe i Lulzime, me datelindje 21/02.1986 lindur ne GJIROKASTER dhe banues ne Tirane, me adrese Rr. Qemal Stafa, Pallati 66/1, H. 6 Ap. 29 Njesia Administrative Nr. 2 Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me Leternjoftimin nr. 035320491 dhe nr. Personal I60221062W

Ne cilesine e ortakut te vetem themelues, deklarom se me vullnet te lire e te plote ne baze te kodit Civil te RSH, Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, si edhe Ligjin Nr. 9723, date 3.5.2007, Nenet 26, 28, 32 e 35, “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, vendos themelimin e Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuara “KAÇI LAW & IMMIGRATION” sh.p.k., shoqeri private e se drejtes shqiptare, krijimi, funksionimi i se ciles percaktohet si me poshte vijon:

**KREU I  
NENI- 1:  
EMERTIMI I SHOQERISE**


- 1.1 Shoqeria do te quhet “KAÇI LAW & IMMIGRATION” sh.p.k., dhe eshte person juridik privat i se drejtes Shqiptare, i themeluar dhe do te ushtroje veprimtarine ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise. Kjo shoqeri ne llojin e saj eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
- 1.2 Veprimtaria dhe funksionim i kesaj shoqerise rregullohet sipas neneve te statutit dhe akt themelimit te kesaj shoqerie dhe ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

**NENI – 2  
SELIA E SHOQERISE**

- 2.1 Shoqeria do te kete seline qendrore te saj ne adresen: BLV “Gjergj Fishta”, pallati “Gora”, kati 9 apartamenti 41, Tirane, dhe me te drejte te shtirjes se aktivitetit te saj ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe jashte saj, nese do te jete e nevojshme duke percaktuar me vone adresat sekondare.

**NENI 3  
VULA E SHOQERISE**

- 3.1 Shoqeria ka vulen e saj, permbajtja e saj do te jete si vijon: “KAÇI LAW & IMMIGRATION” dhe ne mes te vules do te jete ikona “Liber i hapur dhe Pende”
- 3.2 Cdo ortak i cili do ti shtohet shoqerise dhe do te behet pjese e saj bazuar dhe ne ligjet e Republikes se Shqiperise, do te perdore vulen e shoqerise, ne perjashtim te rasteve te specifikuara sipas ligjeve te posacem te legjislacionit Shqiptar.



**NENI -4**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

- 4.1 Shoqeria “KAÇI LAW & IMMIGRATION” sh.p.k., ka per objekt te veprimtarise se saj dhe do te ushtroje aktivitetin si me poshte por pa u kufizuar ne:
- Ofrimin e çdo lloj konsulence tek personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, publike dhe/ose private si shoqëritë tregtare, organizmat tregtare qeveritare, organizatat jofitimprurëse, fondacionet, institucionet shtetërore, ministritë, departamentet qeveritare dhe autoritetet publike dhe në veçanti konsulencë në lidhje me çështjet organizative, administrimin e biznesit, menaxhimin, marketingun, konsulencë për taksat dhe tatimet si dhe planifikimin e përgjithshëm të tyre, burimet njerëzore dhe konsulencë të përgjithshme për shoqëritë që veprojnë në sektorët e biznesit dhe të industrisë, brenda kufizimeve të parashikuara në ligj.
  - Ofrimin e te gjitha sherbimet ligjore te cilat njeh Republika e Shqiperise, te cilat mund te jepen nga nje person juridik privat ne perputhje me Kushtetuten e RSH dhe legjislacionin ne fuqi, ne mometin e hyrjes ne fuqi te ketij akti.
  - Konkretisht ushtrimin e veprimtarise ne fushen e avokatise, si dhe te sherbimeve te tjera te konsulences juridike, te cfaredo fushe te se drejtes.
  - Konsuleca juridike ne fusha te ndryshme te saj.
  - Perfaqesimin e paleve ne te gjitha shkallet e gjyqesorit, ne RSH dhe jashte saj ne rast nevojje, per gjykimin e ceshtjeve civile, penale dhe administrative, si dhe ato ne arbitrazh dhe ne organe te tjera shteterore per ceshtje administrative.
  - Pergatitje te kerkese padive ose te kerkeseve dhe akteve te tjera ne fushen penale, civile, administrative, arbitrazhit, ndermjetesimit etj.
  - Pergatitje te kerkeseve ankimore kunder vendimeve gjyqesore, te prokurorise, te arbitrazhit e te organeve te administrates shteterore.
  - Pergatitja e ankesave dhe kerkeseve te personave fizike e juridike, drejtuar cdo subjekti shteteror apo privat per llogari te ankuesit.
  - Konsulence dhe perfaqesim te shoqerive tregtare.
  - Perpilim i akteve qe vertetohen nga noteri.
  - Hartimi i kontratave dhe marreveshjeve, si dhe çdo dokument tjetër qe sjell ose synon te sjelle krijimin, shuarjen e pasojave juridike.
  - Pjesemarrje si mbrojtës gjatë ndalimit të personit dhe në hartimin e gjykimit të ceshtjeve penale.
  - Konsulence për administrimin, shitblerjen, dhënien me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të veprave civile, tregtare, industriale, publike apo private duke përfshire pa u kufizuar në: ndërmjetësim për kryerjen e veprimeve të mësipërme midis personave juridike privat apo publik, vendas apo të huaj dhe personave fizik, marketing, ekspertize shitje, menaxhim prone.
  - Marrjen persiper te te gjitha te drejtave te realizuara ne te shkuaren prej ortakut dhe administratorit te saj, gjate detyres se tij si avokat ne vitet e meparshme, duke neneshkuar kontrata, nenkontrata,



duke faturuar kliente te vjeter te administratorit dhe ortakut te shoqerise dhe duke perfituar te drejta por jo detyrime te tij te realizuara dhe fituara ne te shkuaraen por te pa ekzekutuara.

- Perfaqesimin ne fushen emigrimit te shtetasve shqiptare dhe te huaj duke i perfaqesuar ata gjate aplikimeve per viza turistike, viza studimi, viza pune, viza leje e perkohshme/leje e perhershme, aplikime per shtetesi te shtetasve shqiptare dhe te huaj ne Shqiperi, Kanada, USA, Britani e Madhe, shtetet Shengen, aplikim per kontroll/revokim espulsi perpara organeve te shteteve Shengen etj
- Si dhe cdo veprimtari tjeter te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit Shqiptar.

## **NENI 5**

### **USHTRIMI I VEPRIMATRISE**

#### **5.1 Per realizimin e objektit te veprimtarise shoqeria mund:**

- Te lidh kontrata me klientet qofte person fizik ose juridik, Shqiptare apo te huaj.
- Te themeloje partneritete per kryerjen e sherbimeve si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise;
- Te marre pjese me aksione edhe ne shoqeri te tjera vendase, te huaja ose me kapital te perbashket qe kane objekt shoqeror dhe aktivitet te ngjashem me te;
- Te krijoje filiale dhe zyra perfaqesie ne qytete te tjera te Shqiperise ose ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e tyre.
- Te kryeje cdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie marrje me qira, te vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivitete keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e Shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper; te kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti qeben pjese ne objektin e saj, qe lidhet me te dhe qe e mbeshtet ate. Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes.
- Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut dhe akt themelimi.

Cdo veprimtari e kryer nga "KAÇI LAW & IMMIGRATION" shpk, brenda territorit shqiptar, do te jete ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.


## **NENI - 6**

### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

**6.1** Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe pa afat.

**6.2** Ajo mund shperndahet me vendim te Ortakut te saj ose te perfaqesuesit te tij me Prokure te Posacme per shperndarjen e Shoqerise, ose kur shperndarjen e saj e percakton vete legjislacioni ne fuqi.

## **KREU II**



**KAPITALI**  
**NENI - 7**  
**KAPITALI THEMELTAR, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

- 7.1. Kapitali fillestar per ushrimin e veprimtarise se shoqerise eshte 100 ( njeqind ) Leke. Ortaku i vetem themelues **Z. ARBËR KAÇI** : Zoterues i nje kuote te plote me vlere nominale 100 (nje qind) leke dhe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar.
- 7.2 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet / pakesohet me vendim te ortakut te vetem, duke bere ndryshimet perkatese ne Aktin e Themelimit, mbeshtetur ne percaktimet ligjore ne fuqi.
- 7.3 Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakut te vetem te shoqerise sipas perqindjes se zoterimit te kuotes perkatese ne kapital.

**NENI - 8**  
**TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR**

- 8.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise apo te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen apo kalohen si me poshte vijon:  
-kontributit ne kapitalin e shoqerise;  
-shitblerje;  
-trashegimi;  
-dhurim;  
-cdo menyre tjeter qe parashikohet ne ligj.
- 8.2. Ne rastin e kalimit te kuotave nepermjet kontrates, duhet qe kontrata te behet ne forme te shkruar nga palet. Palet pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet ndaj shoqerise nga momenti i kalimit te kuotave deri ne monetin e rregjistrimit e kontrates ne Qendren kombetare te Biznesit, rregulluar me Ligjin Nr. 9723, date 3.5.2007, , "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te behen me akte noteriale dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.
- 8.3 Ne rastin e 2 (dy) ose me shume ortakve transferimi i kuotave të Shoqërisë ndaj palëve të treta i nënshtrohet së drejtës së parablerjes në favor të ortakëve.
- 8.4 Kalimi i aksioneve kushtëzohet nga pëlqimi i organeve drejtuese të shoqërisë dhe nga e drejta e parablerjes, në favor të aksionerve të tjerë.
- 8.5 Ortaku ( « Ofruesi » ) që dëshiron të shesë, dhurojë apo transferojë në cfarëdo mënyre kuotat e tij ( « Kuotat e Ofruara » ) duhet të njoftojë me shkrim Administratorin ( « Njoftimi » ) mbi transaksionin që dëshiron të kryejë ( « Transaksioni » )

Njoftimi duhet të përmbajë identitetin e blerësit potencial, numrin e Kuotave të Ofruara, cmimin e ofruar dhe kushtet e tjera materiale të transferimit.

Administratori duhet të mbledhë Asamblenë e Jashtëzakonshme të Ortakëve brenda 3 ( tre ) muajve nga data e marrjes dijeni të Njoftimit.

Asambleja e Jashtëzakonshme e ortakëve mund të miratojë ose të refuzojë Transaksionin.

Nëse Asambleja e Jashtëzakonshme e ortakëve miraton Transaksionin, ofruesi është i lirë të transferojë



pronësinë e kuotave në përputhje me të dhënat e përcaktuara në Njoftim. Cdo transferim i ndryshëm nga ai i përshkruar në Njoftim është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon pasoja. Në këtë rast, Shoqëria njih si pronar të kuotave të Ofruara vetëm Ofruesin.

Nëse Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve refuzon Transaksionin, ofruesi mund të heq dorë nga transferimi.

Në rast se Ofruesi nuk heq dorë nga transferimi, Shoqëria brenda 3 muajve nga data e mbledhjes së parë, ose

- (i) gjen një blerës ( "Blerës i Pranuar") që pranon të blejë Kuotat e Ofruara sipas Njoftimit; ose
- (ii) shoqëria blen kuotat e Ofruara dhe i anulon ato. Cmimi I blerjes në këtë rast vendoset me marrëveshje midis Ofruesit dhe Shoqërisë. Nëse marrëveshja nuk arrihet, cmimi vendoset nga një ekspert i pavarur i emëruar me marrëveshje midis Ofruesit dhe Shoqërisë.
- (iii) Administratori thërret Asamblesë e Jashtëzakonshme të ortakëve për t'u shprehur në lidhje me paragrafet më sipër, brenda tre muajve nga data e mbledhjes së parë të Asamblesë.  
Mbledhja e dytë e Jashtëzakonshme e Ortakëve miraton shitjen tek Blerësi I Pranuar ose miraton blerjen e Kutoave të Ofruara nga Shoqëria me qëllim për t'i anuluar. Mbledhja vendos për transaksionin e blerjes, financimin e shoqërisë për të bërë këtë blerje dhe procedurën e anulimit.

#### **Transferimi i kuotave me trashëgimi ose falimentim**

8.6. Nëse ortaku vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët do të jenë personat e vetëm të njohur nga Shoqëria si gëzues i të drejtave mbi kuotat e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij statuti dhe akt themelimi, pasuria e ortakut të vdekur nuk clirohet nga përgjegjësia në lidhje me cdo kuotë të bashkëzotëruar me persona të tjerë,

8.7 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes së ortakut, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotave ose të kërkojë regjistrimin e kuotave në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotave

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**


##### **NENI 9**

#### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë janë:

1- Asambleja e Ortakëve.

2- Administratori.



## NENI 10

### ASAMBLEJA E ORTAKËVE

- 10.1 Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve e cila mund të thirret nga ortaku i vetë.
- 10.2 Nëse shoqëria do të ketë në të ardhmen më shumë se një ortak Asambleje e Ortakëve mund të therrë çdo anëtar i shoqërisë që përfaqëson të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë. Anëtarët duhet të njoftohen me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike, jo më vonë se 7 ditë përpara dhe në lajmërim duhet të jetë shkruar vendi, ora dhe çështjet e rendit të ditës që do të trajtohen në mbledhje.
- 10.3 Në qoftë se Asambleja nuk është mbledhur sipas rregullave të caktuara ajo mund të marrë vendim kur çdo anëtar i shoqërisë është prezent dhe janë dakort të marrin vendime pavarësisht parregullsisë.

## NENI 11

### TË DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE

Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme.

1) *Asambleja e Zakonshme:*

Mbledhet të paktën 1 herë në vit, dhe sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Asambleja e zakonshme e ortakëve merr vendime të vlefshme si më poshtë:

- a) Në thirrjen e parë në praninë e ortakëve që janë vetë prezent ose të përfaqësuar nga persona të tretë me prokurë të posaçme dhe që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave në kapitalin e shoqërisë.
- b) Në rast se nuk sigurohet kjo shumicë, në mbledhjen e dytë vendimet merren me shumicën e votave të dhëna nga ortakët prezentë pavarësisht nga përqindja e kapitalit që ato përfaqësojnë.

Kompetencat e Asamblesë së Zakonshme:

Asambleja e Zakonshme e ortakëve ka kompetencat e mëposhteme:

- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të Asamblesë.
- Përcakton shpërblimin për administratorin, ekspertet, revizorët kontabël.
- Ka të drejtë të miratojë bilancin e shoqërisë dhe të bëjë ndarjen/investimin e fitimit.
- Vendos edhe për çdo çështje tjetër që nuk sjell ndryshime në statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë ose nuk është lënë në kompetencë të Asamblesë së Jashtëzakonshme

## 2) Asambleja e Jashtëzakonshme:

Në mbledhjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme vendimet do të jenë të vlefshme në rast se ato do të merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën ½ (nje te dyten) e pjesëve të kapitalit themeltar.

Në rast se Asambleja e Jashtëzakonshme nuk mund të marr vendime për shkak të barazimit të votave të Ortakeve, atëherë ortakët kanë të drejtë procedojnë dy mënyra :

a) të ngrenë një komitet të përbërë nga një ose shumë ekspertë kontabël, vota e të cilëve do të jetë përcaktuese.

ose,

b) ortakët me marrëveshje midis tyre do tja nënshtrojnë vendimarrjen procedurës së Arbitrazhit.

Asambleja e Jashtëzakonshme e ortakeve ka kompetencat e mëposhtme:

- Të marrë në shqyrtim dhe ka të drejtë të miratojë të gjithë ndryshimet e statutit.
- Bën transferimin e kuotave të të tretët.
- Realizon blerjen, shitjen dhe transferimin e pasurive të paluajtshme të shoqërisë etj, dhe vendos në lidhje me këto çështje;
- Vendos në lidhje me çdo çështje të lidhur me pasurinë e shoqërisë, marrje hua, vendosje hipoteke, barrë siguroese etj .
- Vendos për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera për hapje dege, filiale, zyra përfaqësimi etj .
- Si dhe çdo çështje tjetër që nuk është në kompetencën e Asamblesë së Zakonshme.

### NENI 12

12.1 Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme të Ortakëve të cilat janë marrë në një mbledhje të thirrur në mënyrë të rregullt dhe konform kontratës së themelimit, Statutit e të ligjeve janë të detyrueshme për të gjithë ortakët e tjerë, edhe për ata që nuk kanë diskutuar ose nuk kanë qenë dakord. Cdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër që nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund të përfaqësojë më shumë se një ortak.

Në Asamblesë e Ortakëve marrin pjesë nëse është e nevojshme për të dhënë mendim eksperte, revizore etj.


Nese shoqëria ka me shume se nje ortak, secili prej tyre ka të drejtë të marrë pjesë në vendime si dhe disponon një numër votash të barabarte me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.

Një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak ose nga një person tjetër me prokurë të posacme.

### NENI 13

Marrja e vendimeve të Asamblesë, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

### NENI 14



## ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga një administrator, i cili caktohet në statutin e shoqërisë dhe me pas nga Asambleja e Ortakëve. Administratori qendron në detyrë për një periudhë 1 vjecare me të drejtë riperseritjeje. Në rast se gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e tyre, Asambleja e Ortakëve vendos shkarkimin e administratorëve duke treguar me fakte demin që i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tyre pasi është dhënë mendimi për këtë dëm edhe nga specialistët përkatës. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretët në emër të shoqërisë dhe në interes të saj në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe Statuti i shoqërisë ua jep shprehimisht ortakëve.

Shoqëria do të administrohet nga administrator:

- **Z. ARBËR KAÇI** i biri i Viktor dhe i Lulzime, me datelindje 21/02.1986 lindur ne GJIROKASTER dhe banues ne Tirane, me adrese Rr. Qemal Stafa, Pallati 66/1, H. 6 Ap. 29 Njesia Administrative Nr. 2 Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me Leternjoftimin nr. 035320491 dhe nr. Personal I60221062W

### NENI 15


Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në Statut që i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

### NENI 16

- 16.1 Administratori ka të drejtë të nënshkruajë kontrata të ndryshme për furnizime publike private, të ndërmarrin veprime gjyqësore për dhe në emër të shoqërisë, etj. Administratori mund të japë prokura në kufijtë që ju lejon Asambleja e Ortakëve për kategori të caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për cdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.
- 16.2 Administratori është i detyruar të mbajnë konform ligjit të gjitha rregjistrat e domosdoshme për aktivitetin e shoqërisë. Administratori i shoqërisë është i detyruar të mbajnë inventare të rregullta një herë në muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratorët.
- 16.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim apo mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 16.4 Administratori është përgjegjës për administrimin e shoqërisë dhe informon ortakun për ecurinë e veprimtarisë tregtare të shoqërisë. Gjatë veprimtarisë së tij ai vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë, duke zbatuar parimet e detyrimit të besnikërisë.

### NENI 17

## MARRËDHËNIET E PUNËS





Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të të punësuarit, Statutin dhe akt themelimin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

## **NENI 18**

### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratori i kësaj shoqërie.

## **NENI 19**

### **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

## **NENI 20**

### **BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE**

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet në dt. 31 Dhjetor të cdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si më sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten i kalojnë ortakut dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore, ose të ardhurat mund të investohen në kapital ose në shoqëri, sipas vendimtarjes që do të marrë Asambleja e Ortakëve

## **NENI 21**

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të realizuara rezulton më pak se kapitali themeltar, pronari vendos brenda 4 muajve për mundësinë e prishjes së shoqërisë.

## **NENI 22**

### **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

Në rast se shoqëria prishet për cdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton menyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për c' regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.



**NENI 23**  
**LIBRAT E SHOQERISE**

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve te organit administrativ
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

**NENI 24**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Persa eshte shprehur ne kete statut dhe akt themelimi i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky statut dhe akt themelimi dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ky statut dhe akt themelimi nenshkruhet rregullisht nga ortaku i shoqerise.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË**  
**"KAÇI LAW & IMMIGRATION" Sh.P.K.**

**ARBËR KAÇI**

